



**KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR**  
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ  
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

Numër: 601-01/24

Data: 28.10.2024

Bujanoc

Në bazë Nenit 113 paragrafi 2 pika 1 të Ligjit për Këshillat Kombëtare të Pakicave Kombëtare (Fletorja zyrtare R.S. 72/2009,20/2014 - vendimi i GJK 55/2014 dhe 47/2018) dhe neni 14, paragrafi 1, pika 3 dhe 20 e Statutit të Këshillit të Kombëtar Shqiptar nr.284-01/23 të datës 06.07.2023, si dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar Shqiptar nr.597-01/24 të datës 26.10.2024 shpall:

### **THIRRJE PUBLIKE**

#### **PËR SUBVENCIONIMIN E KULTURAVE BUJQËSORE NË LUGINË TË PRESHEVËS**

Ftohen të gjithë shqiptarët që jetojnë në Luginën e Preshevës e që merren me kultivimin e kulturave bujqësore, të aplikojnë për ndihmë të njëhershme që Këshilli Kombëtar Shqiptar ndanë në zbatim të përkrahjes për Luginën e Preshevës nga Fondi i Qeverisë që ka për qëllim mbështetjen financiare për zbatimin e kulturave bujqësore.

Për subvencionet në bujqësi, do të përfshihen të gjithë banorët shqiptarë nga Lugina e Preshevës që merren me një nga kulturat bujqësore e me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të tyre prodhuese, si dhe për të rritur efikasitetin e për të përmirësuar standardin e jetesës në këtë rajon. Shuma e ndihmës së njëhershme financiare (subvencionit) do të varet nga madhësia e veprimtarisë me të cilën aplikon, e cila shumë do të përcaktohet në Këshillin Kombëtar Shqiptar pas përfundimit të procesit të vlerësimit preliminar dhe përfundimtar.

#### **E drejta për të marrë pjesë**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë banorët shqiptarë të Luginës së Preshevës, që merren me zhvillimin e veprimtarisë në njërin nga kulturat bujqësore (bujqësi, blegtori, bletari, pemëtari dhe shpezëtari).

Aplikuesi mund të aplikojë vetëm në njërin nga kulturat e lartëcekura bujqësore.

#### **Kriteret për aplikim**

Aplikuesi duhet të jetë pjesëtar i përkatësisë kombëtare shqiptare dhe banor në njërin nga komunat: Preshevë, Bujanoc apo Medvegjë.

Të ketë një aktivitet bujqësor të cilin e zhvillon në njërin nga këto komuna.

Te kulturat bujqësore:

- **Bujqësi**, aplikuesi duhet të posedojë tokë bujqësore – minimalisht 5.000 metra katrorë të punueshme;
- **Blegtori**, aplikuesi duhet të sjell vërtetimin e shërbimit të Veterinarisë, për të dëshmuar



**KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR**  
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ  
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

- se është i regjistruar si blegtor;
- **Bletari**, aplikuesi duhet të sjell vërtetimin e shërbimit të Veterinarisë, për të dëshmuar se është i regjistruar si bletar;
  - **Pemëtari**, aplikuesi duhet të posedojë tokë bujqësore – minimalisht 1.000 metra katrorë të punueshme;
  - **Shpezëtari**, aplikuesi duhet të sjell vërtetimin e shërbimit të Veterinarisë, për të dëshmuar se është i regjistruar si shpezëtar.

### **Dokumentacioni i kërkuar**

Formulari i aplikimit i plotësuar dhe i nënshkruar (të shkarkuar nga faqja zyrtare e KKSH-së)

Përveç formularit të lartpërmendur, aplikuesi duhet bashkëngjitur të dorëzojë edhe këto dokumente:

- Letërnjoftimi i lexuar;
- Ekonomia bujqësore (vërtetimi/aktvendimi nga organi kompetent, jo më i ri se 31.08.2024);
- Dëshmia e bashkësisë lokale për vërtetimin e të dhënave;
- Qiraja e tokës (kontrata mbi qesimin e tokës e vërtetuar te noteri, për aplikuesit që nuk e kanë të regjistruar ekonominë bujqësore);
- Lista poseduese (vërtetimi jo më i vjetër se 3 muaj nga dita e shpalljes së Thirrjes, për aplikuesit që nuk e kanë të regjistruar ekonominë bujqësore)
- Pasqyra e të ardhurave për vitet e fundit (nëse ka fermë) dhe
- Numri i llogarisë bankare (llogaria duhet të jetë e hapur në emër të aplikuesit)

### **Afati i aplikimit**

Ftesa për aplikim në Thirrjen për subvencionimin e kulturave bujqësore fillon nga data **30 tetor 2024 ora 09:00** dhe zgjatë deri më **8 nëntor 2024 ora 15:00**.

Aplikacionet dorëzohen fizikisht në ambientet e selisë së Këshillit Kombëtar Shqiptar, në Rr. Karagjorgje Petroviq, nr. 237, çdo ditë pune gjatë orarit 09:00-15:00.

Format për aplikim si dhe të gjitha informatat tjera gjinden në **www.kksh.org** (website i KKSH-së). Për informata shtesë mund të shkruani në **kksh.grantet@gmail.com** ose na telefononi në nr. **0628903830**.

Vetëm aplikimet e dorëzuara brenda afatit dhe me dosje të plotë do të shqyrtohen.

### **Mënyra e aplikimit**

Aplikimet me dokumentacionin e paraparë dorëzohen në adresën Rr. Karagjorgje Petroviq, nr. 237, Bujanoc me shenimin: **“THIRRJE PUBLIKE PËR SUBVENCIONIMIN E KULTURAVE BUJQËSORE NË LUGINË TË PRESHEVËS”**. Në anën e pasme të zarfit





**KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR**  
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ  
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

duhet të shkruhet emri dhe mbuemri dhe adresa e plotë e aplikuesit.

Aplikimet e dërguara në ndonjë mënyrë tjetër (postë, email apo fax) nuk do të merren parasysh.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk i kthehet aplikuesit.

Nuk do të merren parasysh aplikimet: e parakohshme; me dokumentacion jo të plotë; që nuk janë të dorëzuara në formularin përkatës; nga personat e paautorizuar dhe që nuk janë në përputhje me qëllimin e mjeteve të përcaktuara me këtë Thirrje publike.

**Lista e vlerësimit dhe rangimit të aplikacioneve të paraqitura**

Komisioni vlerësues përcakton listën e vlerësimit dhe rangimit të aplikimeve të paraqitura brenda një afati që nuk mund të jetë më i gjatë se 10 ditë nga përfundimi i afatit për aplikim dhe e publikon listën preliminare në faqen zyrtare të KKSh.

Pjesëmarrësit në konkurs kanë të drejtën e ankimit në Komisionin Ankimor të KKSh brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e shpalljes së listës preliminare.

Vendimi për pagesën e mjeteve merret nga Këshilli Kombëtar Shqiptar, bazuar në listën e vlerësimit dhe rangimit të aplikimeve, brenda 15 ditëve nga data kur lista bëhet përfundimtare, përkatësisht nga bartja e mjeteve në llogarinë bankare të KKSh nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Lista përfundimtare publikohet në web faqen zyrtare të Këshillit Kombëtar Shqiptar.



**KRYETAR**

*Nezad Lutfiu*  
**Nezad Lutfiu**